PUBLIC
Date original: 07/12/2020 15:43:00
Date public redacted version: 12/12/2020 12:45:00

ANNEX 1 to

Defence Application for Interim Release

Public

Date original: 07/12/2020 15:43:00 Date public redacted version: 12/12/2020 12:45:00



1 dhjetor 2020

I nderuar z. Gjyqtar,

Kam nderin dhe privilegjin të shkruaj këtë deklaratë në mbështetje të aplikimit për lirim me kusht të z. Rexhep Selimi përpara Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë. Me këtë deklaratë unë shpreh konsideratën dhe respektin më të lartë për karakterin e tij.

Unë quhem Albin Kurti, themelues dhe kryetar i partisë Lëvizja VETËVENDOSJE! (LVV) dhe ish Kryeministër i Kosovës.

Me Rexhep Selimin jam njohur fillimisht nëpërmjet veprës së tij patriotike, si një prej themeluesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dhe më vonë si bashkëveprimtar në LVV. Në tërë njohjen time prej dy dekadash, Rexhepi për mua ka përfaqësuar njeriun me integritetin dhe me virtyte më të larta morale dhe njerëzore.

Si kolegë deputetë që ishim, Rexhep Selimi ka qenë përherë i përpiktë në detyrat që ka marrë përsipër, koherent në qëndrimet dhe përcaktimet që ka pasur, dhe, i parashikueshëm dhe korrekt në raportet me të tjerët.

Veprimtaria e tij patriotike dhe profesionale gjithmonë është karakterizuar nga përkushtimi i plotë, nderi dhe dinjiteti në ushtrimin e detyrës së tij. Këto detyra nuk kanë qenë të pakta, duke nisur me pozicionin si Ministër i Rendit Publik në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës (1999-2000), atë të Komandantit të Akademisë së Mbrojtjes (2000-2003), dhe së fundmi atë të deputetit të LVV në Kuvendin e Kosovës (2011-).

Rexhep Selimi si qytetar dhe shtetas i Kosovës ka treguar respektin maksimal dhe ka vepruar gjithmonë në përputhje me ligjet dhe rregullat e Republikës së Kosovës. Çdo pretendim i ngritur lidhur me faktin që ai mund të paraqesë rrezik të ikjes bie ndesh me karakterin e Rexhepit dhe përvojën tonë. Për të gjithë ata që e njohin Rexhepin (përfshirë edhe mua) është e paimagjinueshme që ai mund të kryejë një veprim të tillë.

Njësoj, edhe pretendimi se ai mund të ndërhyjë me veprimet e tij në administrimin e drejtësisë së Dhomave të Specializuara në Hagë (në çfarëdo forme), është tërësisht i pabazuar, dhe lehtë i kundërshtueshëm në tërësinë e tij. Kushdo që ka njohur dhe punuar me Rexhepin, mund të tregojë me bindje të plotë se çdo veprim i tillë do të ishte në kundërshtim me atë që Rexhepi përfaqëson me ekzistencën dhe veprën e tij. Prandaj, konsideroj që në vlerësimin e kërkesës për lirim me kusht të shtruar para jush, ju si gjyqtar do ta merrni parasysh karakterin dhe integritetin e lartë të Rexhepit.

Përveç patriotit, politikanit dhe profesionistit, Rexhep Selimi është edhe një bashkëshort dhe baba shembullor e i përkushtuar ndaj familjes së tij. Arrestimi dhe përballja e tij me aktakuzën në Hagë padiskutim që ka shkaktuar një dhimbje të madhe për familjen, andaj lirimi me kusht do t'i ofronte Rexhepit dhe familjes mundësinë për të qëndruar afër njëri-tjetrit në këtë situatë kaq të vështirë.

Date original: 07/12/2020 15:43:00 Date public redacted version: 12/12/2020 12:45:00

VETËVENDOSJË

Mbetem me shpresë që ju si gjyqtar do të mermi në konsideratë gjithë vlerësimin për karakterin dhe integritetin e Rexhepit kur të gjykoni mbi kërkesën e tij për lirim me kusht.

Me respekt,

Albin Kurti

KSC-BC-2020-06/F00124/RED/A01/4 of 5

PUBLIC

Date original: 07/12/2020 15:43:00 Date public redacted version: 12/12/2020 12:45:00

UNOFFICIAL TRANSLATION

1 December 2020

Your Honour,

I have the honour and privilege to write this statement in support of the application for provisional release of Mr Rexhep Selimi before Kosovo's Specialist Chambers in The Hague. With this statement, I would like to express my highest consideration and respect for Rexhep's

character.

My name is Albin Kurti, founder and leader of the political movement and party Vetëvendosje

LVV (Self -Determination) and former Prime Minister of Kosova.

I have come to know Rexhep Selimi initially through his patriotic work [actions], as one of the

founders of the Kosovo Liberation Army (KLA), and later as an active member of the KLA.

In my twenty years of knowing him, Rexhep has represented always the man with the highest

moral and human integrity and virtues.

As colleagues, members of the Assembly, Rexhep has always honoured his obligations, has

been reasoned [coherent/ consistent] in his attitudes, and reliable and correct in his relations

with others.

His patriotic and professional activity has always been characterised by complete dedication,

honesty and dignity in the exercise of his duty. His tasks have not been few, starting with his

position as Minister of Publica Order in the Interim Kosovo Government (1999 – 2000), that

of Commander of the Defense Academy (2000 – 2003), and more recently that of the member

of the Assembly representing LVV (2011 -).

As a citizen of Kosovo, he has shown the maximum respect and has always acted in accordance

with the laws and rules of the Republic of Kosovo. Any claim that may be raised that he may

be a flight risk contradicts his character and what I know from our experience. For all those

who know Rexhep (including myself), it would be unimaginable to think of him acting that

way.

KSC-BC-2020-06/F00124/RED/A01/5 of 5

PUBLIC

Date original: 07/12/2020 15:43:00 Date public redacted version: 12/12/2020 12:45:00

UNOFFICIAL TRANSLATION

Likewise, the claim that he may interfere with his actions in the administration of justice of the

Specialist Chambers in The Hague (in whatever form) is totally unbased [unsubstantiated]. And

easily contradictable in all its entirety. Anyone who has known and worked with Rexhep, can

say with full conviction that any such action is in contradiction with who Rexhep is and

represents with his work. Therefore, I would hope that in your assessment of the request for

provisional release, you would take into consideration Rexhep's high character and integrity.

Aside from being a patriot, a politician, and a professional, Rexhep Selimi is also an exemplary

father and husband, who is dedicated to his family. His arrest and him facing the indictment in

The Hague have undoubtedly caused a great pain to his family, and therefore his provisional

release would offer Rexhep and his family the opportunity to stay close to each in this very

difficult situation.

I remain hopeful that you as a judge would take into consideration the character and integrity

of Rexhep when adjudicating upon his request for provisional release.

Respectfully,

Albin Kurti